

# 2009

Katër vite nga marrja e statusit – vend kandidat:

Çfarë është bërë dhe cilat janë pritjet?



Analitika

Shtator 2009

## Hyrje

Shumë është thënë dhe bërë në katër vitet e fundit që kur Maqedonia u bë vend kandidat për në BE. Me afrimin e datës së publikimit të raportit vjetor të KE, pyetjet nëse ky vit do të jetë vit për marrjen e datës për fillimin e negociatave për anëtarësimin e plotë po okupojnë diskutimet publike. Për të gjetur një përgjigje të shpejtë ndaj kësaj pyetjeje duket detyrë mjaft e vështirë. Problemet nuk rrjedhin vetëm nga shqetësimet e brendshme - të ndërlikuara dhe sfiduese, por edhe nga konfuzioni mbi të ardhmen e Evropës brenda kryeqyteteve të Evropës dhe Brukselit. Rruga e Maqedonisë nëpër të cilën duhet të ecë për të arritur destinacion e shumëkërkuar – Brukselin, është veçanërisht e vështirë dhe plot me pengesa. Përveç çështjeve të brendshme dhe mosmarrëveshjeve me fqinjët e saj, Maqedonia gjithashtu duhet të gjejë një mënyrë për të "fituar" Evropën, krahas krizës globale ekonomike dhe ratifikimit të pambaruar të Traktatit të Lisbonës. Duket si mision i pamundur kur kombinohen gjithë këto, megjithëse kjo mund të realizohet.

Ky raport do të fokusohet pikërisht në këtë, shanset reale për marrjen e rekomandimeve për fillimin e negociatave të anëtarësimin të plotë me BE nëpërmjet analizës së zhvillimeve në katër vitet e fundit dhe ndikimi i tyre mbi këtë proces. Gjithashtu, do të prezantohen dhe diskutohen opinionet e palëve të interesuara përkatëse në Maqedoni dhe jashtë vendit që janë të përfshira direkt në procesin e antarësimin në BE (Qeveria, Misioni i KE-së në Shkup) ose të tjerë që janë ekspertë të kësaj teme dhe që ndjekin nga afër zhvillimet në Maqedoni dhe në Ballkanin Perëndimor në marrëdhëniet e tyre me BE. Analiza përfundimtare do të mundohet të merret me këtë pyetje: Sa të mëdha janë gjasat e Maqedonisë për të marrë rekomandimin e datës për fillimin e negociatave me BE?

Struktura e raportit është e konceptuar sipas pjesëve të mëposhtme. Në pjesën e parë të raportit do të përshkruhen ngjarjet e katër viteve të fundit në Maqedoni. Përmbledhje e veçantë do të bëhet për zhvillimet që ndodhën rreth Samitit të NATO-s në Bukuresht, Rumani në vitin 2008, në të cilin u vendosën marrëdhëniet e saj me organizatat Euro-Atlantike. Përparimi i Maqedonisë në aspekt të reformave të bëra është vlerësuar në pjesën e dytë. Zhvillimet e fundit në vend, me theks të veçantë mbi vitin e kaluar (2009) dhe ndikimi që mosmarrëveshja për emrin ka mbi procesin e integritit të Maqedonisë në strukturat Euro-Atlantike është diskutuar në pjesën e tretë. Analiza përfundimtare paraqet pjesë të mendimeve të aktorëve kryesorë në marrëdhëniet BE-Maqedoni shoqëruar me pozicionimin e Analytica-s mbi çështjen e përgatitjes së Maqedonisë për të filluar negociatat, gadishmërinë e KE-së për të propozuar datë për negociata si dhe nëse skenari I pritjes mund të jetë po aq I dëmshëm sa mendohet të jetë.

1. Shpjegimi kronologjik i ngjarjeve që ndodhën në katër vitet e fundit:

1.1 2005-2006

1.2 2006-2007

1.3 Tetë standartet e BE-së

Politika e BE-së “carrot and stick” është e njohur gjerësisht, veçanërisht në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Pas negociatave me vite, reformave të dhimbshme dhe konflikteve, BE-ja në Samitin Evropian në Britani të Madhe, të mbajtur në dhjetor të vitit 2005, vendosi për t'i dhënë Maqedonisë, Kroacisë dhe Turqisë statusin e kandidatit.<sup>1</sup> Kjo Politikë e BE-së është hartuar për të shtyrë rajonin përpara dhe t'u japë stimuj të gjitha vendeve të BP-së për të vazhduar me reformat pavarësisht çështjeve të brendshme të BE-së dhe lodhjes nga zgjerimi.

1.1 përparimi i Maqedonisë që nga kjo datë ka pasur disa ngritje dhe për fat të keq, shumë rënie. Ndryshimi i parë i madh ka ndodhur në vitin 2006 në zgjedhjet parlamentare, në të cilat VMRO-DPMNE e udhëhequr nga koalicioni fitoi shumicën e vendeve në parlament (45 nga 120) dhe mori pushtetin nga SDSM.<sup>2</sup> Ndërsa nga ana tjetër, partia etnike shqiptare BDI (Bashkimi Demokratik për Integritet) fitoi 60% të votave të komunitetit etnik shqiptar, por u la jashtë qeverisë sepse PDSH (Partia Demokratike e Shqiptarëve)<sup>3</sup>, ishte zgjedhja e VMRO-së për partner të koalicionit. Kjo rezultoi në bojkot të parlamentit nga ana e BDI-së si shenjë proteste që nuk qenë të ftuar të jenë pjesë e qeverisë së re.

1.2 Në shtator të vitit 2007 gjatë votimit për kodin zgjedhor u shënua një ballafaqim në parlament, e cila u shkallëzua në dhunë fizike mes partive etnike shqiptare. Njerëz të tjerë u plagosën gjithashtu, duke përfshirë edhe gazetarët. Ky incident ishte rezultat i raporteve të nxehura mes dy partive më të mëdha shqiptare që nga zgjedhjet parlamentare në 2006 kryesisht lidhur me zgjedhjen e partnerit shqiptar në qeveri. Fakti që shumë pak përpjekje qenë bërë në procesin e ndërmjetësimit për të zgjidhur grindjet ndër-partiake, të cilat bllokuan procesin e reformave të rëndësishme, rezultoi në kritika nga ana e Brukselit. I pritur në një vizitë nga Presidenti i atëhershëm Z. Branko Crvenkovski, Oli Rehn pyetjes së një gazetari i qe përgjigjur: "Si mund të prisni vendime të mëdha nga ne kur ndodhin gjëra të tilla."<sup>4</sup>

1.3 Para se të diskutohen incidentet zgjedhore, ky raport do të fokusohet paraprakisht në një praktikë që ishte prezantuar nga Komisioni pas ngjarjeve elektorale të vitit 2007.<sup>5</sup> Ke vendosi kushte të reja dhe vetëm me plotësimin e tyre mund që Maqedonia të shpresojë për të marrë datë për fillimin e bisedimeve. Këto kushte janë të njohura edhe si tetë standarde të BE-së dhe ato janë:

1. Dialog konstruktiv politik.
2. Zbatimi efektiv i ligjit të ri mbi policinë.
3. Depolitizimi i administratës publike.
4. Përmirësimi i klimës së biznesit.

---

<sup>1</sup> Carrot and stick policy referohet premtimit për shpërblim - “the carrot” kombinuar me kërcënimin e forcës – “the stick” sanksionet nëse kushtet e vendosura nga BE-ja nuk plotësohen nga vendet përkatëse.

<sup>2</sup> VMRO-DPMNE (djathtiste) dhe LSDM (majtiste) janë dy partitë më të mëdha etnike maqedonase.

<sup>3</sup> BDI dhe PDSH janë dy partitë kryesore të shqiptarëve.

<sup>4</sup> Slobodanka Jovanovska, Utrinski Vesnik, Brukseli habitet pse po kërkojmë datë për fillim të negociatave. <http://www.utrinski.com.mk/?ItemID=3EDBB9CEF05A1F409E59F23F0421C59E>

<sup>5</sup> Praktika e përmbledhjes së standardeve në një document të caktuar që shtetet duhet t'i plotësojnë me qëllim të progresit në përafrimin me UE-në është praktikë e re. Kjo jep një pasqyrë më të qartë mbi atë se cka duhet bërë.

5. Përshpejtimin e legjislacionit të pronës.
6. Forcimi i pavarësisë së gjyqësorit.
7. Zbatimi në mënyrë të qëndrueshme të legjislacionit anti-korrupsion.
8. Krijimi i kushteve për punësimin e të rinjve.

Këto kushte u krijuan në fund të vitit 2007 dhe që atëherë e deri më sot – shtator 2009, Maqedonia është ende në rrugën e përmbushjes së tyre. Përparimi më i madh ka ndodhur në vitin 2009, ndërkohë që trazirat më të mëdha kanë ndodhur në vitin 2008. Për më tepër, 2008 ishte një vit shumë kritik për Maqedoninë për shkak të Samitit të NATO-s dhe pasojat e tij. Kjo periudhë është karakterizuar me trazira të mëdha, me intensifikimin e negociatave me Greqinë rreth emrit, të ndërmjetësuara nga SHBA-të dhe administrata e Bushit në largim (i etiketuar si pro-maqedonas), Samiti i NATO-s dhe vetoja famëkeqe nga Greqia për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO; zgjedhjet e parakohshme dhe incidentet me pasoja fatale, që rezultuan me vërrejtje të reja nga BE.

Çështjet e mësipërme do të diskutohen më hollësisht në kapitullin e ardhshëm:

## **2. Përmbledhje të veçanta të ngjarjeve para dhe pas Samitit të NATO-s në Bukuresht në 2008.**

### **2.1 Zhvillimet përpara takimit të NATO-s**

### **2.2 Zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe incidentet**

2.1 Pas incidenteve në Kuvend në shtator të 2007 dhe raportit negativ mbi përparimin, në fillim të vitit 2008 Komisioni Evropian dha shpresa për të përcaktuar një datë fillimi për bisedimet e pranimit të Maqedonisë në atë vit. Oli Rehn (Komisioneri i BE-së për Zgjerimin) për stacionin televiziv Kanal 5 deklaroi: "Shpresoj se do të jemi në gjendje të bëjmë këtë sa më shpejt gjatë vitit 2008 i cili është një vit me rëndësi kyçe për Ballkanin Perëndimor".<sup>6</sup> Rëndësia kryesore ishte Samiti i ardhshëm i NATO-s në të cilën vendet e Kartës së Adriatikut (Kroacia, Maqedonia dhe Shqipëria, e krijuar në 2003) priteshte të marrin ftesë për anëtarësim të plotë në NATO. Megjithatë, mosmarrëveshja e emrit me Greqinë gjithmonë e më shumë filloi të kërcënojë tërë marrëveshje disa muaj para Samitit.<sup>7</sup> Në mënyrë dinake dhe të vendosur, Greqia filloi të dërgojë sinjale se pa një kompromis rreth emrit zyrtar të Maqedonisë, veto-ja për hyrjen e saj në NATO do të jetë më se reale. Negociatat filluan të intensifikohen, më shumë për shkak të faktit se ai ishte një vit i zgjedhjeve në SHBA dhe Xhorxh Bush po përfundonte mandatin e tij të dytë dhe të fundit.<sup>8</sup> Të gjitha palët e interesuara, BE, NATO, OKB, Shtetet e Bashkuara dhe ndërmjetësi, Methju Nimitz e këshillonin Maqedoninë se do të duhet të pranojë një kompromis lidhur me emrin e saj para Samitit të Bukureshtit, pasi koha po kalonte dhe të mirat ngadalë po zhvendosueshin nga oborri i Maqedonisë. Megjithatë, as Greqia e as Maqedonia nuk ishin të

---

<sup>6</sup> Balkan Insight, *EU Commissioner Emboldens Macedonia*, 18 Janar 2008.  
<http://www.balkaninsight.com/en/main/news/7434/>

<sup>7</sup> Ky raport nuk do të diskutojë detajisht mbi atë se cka është negociuar në atë periudhë specifike pasi që problem me emrin është një çështje shumë e rëndësishme që nuk mund të përshkruhet me disa fjalë.

<sup>8</sup> George W. Bush dhe Republikanët në përgjithësi llogariteshin si përkras të mëdhenj të Maqedonisë. Në fillim të mandatit të tij të dytë në 2004, SHBA njohën Maqedoninë me emrin e saj kushtetues gjë që shkaktoi tensione të mëdha në Greqi. SHBA dhe NATO gjithashtu kanë për qëllim të stabilizojnë këto shtete dhe të përforcojnë krahun jugor të aleancës me qëllim që të gjitha vendet e Kartës së Adriatikut të pranohen në NATO.

përgatitura që të heqin dorë nga qëndrimet fillestare dhe nuk kishte asnjë zgjidhje kompromisi në prag të Samitit.

2.2 me fillimin e Samitit të Bukureshtit, Greqia vazhdimisht intensifikonte thirrjet për vënien e vetos mbi hyrjen e Maqedonisë në NATO, ndërsa diplomatët punonin me zell mbi arritjen e një marrëveshjeje të mundshme në minutën e fundit midis dy vendeve. "... Pasi vendimet e NATO-s që nga themelimi kanë qenë gjithmonë të sjella në mënyrë unanime, Greqia gjithashtu ka të drejtën e vetos ..."<sup>9</sup> Megjithatë, zgjidhje të minutës së fundit për çështjen e emrit nuk pati dhe Maqedonia nuk u bë shtet anëtar i NATO-s. Këtu është e rëndësishme të theksohet se qëndrimi zyrtar nuk ishte se hyrja e Maqedonisë ishte bllokuar përmes vënies së vetos, paraqit në media. Aleanca iu qas ndryshe kësaj çështjeje dhe në Deklaratën e Samitit të përbashkët u shpreh se: "ne e çmojmë punën e mundimshme dhe angazhimin e treguar nga ... ana e Maqedonisë ndaj vlerave të NATO-s dhe operacioneve të Aleancës ... Brenda kuadrit të Kombeve të Bashkuara, shumë aktorë kanë punuar me përkushtim për të zgjidhur çështjen e emrit, por Aleanca ka vërejtur me keqardhje se këto bisedime nuk kanë prodhuar një rezultat të pritur. Prandaj, ne ramë dakord që ftesa për Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë do të jepet me sa kohë që të gjindet një zgjidhje reciprokisht e pranueshme për çështjen e emrit. Ne inkurajojmë që negociatat të rifillojnë pa vonesë dhe presim që ato të jenë të përfunduara sa më shpejt të jetë e mundur."<sup>10</sup>

Pasi nuk kishte asnjë ftesë për të hyrë në NATO, Maqedonia qe tronditur disi nga paaftësia e të gjitha shteteve të tjera anëtare të NATO-s për të influencuar Greqinë për të lejuar hyrjen e Maqedonisë në NATO. Greqia fitoi luftën dhe shpejt u bë e qartë se emri do të përdoret si kartë edhe në raste të tjera (BE-së në veçanti) nëse nuk arrihet një kompromis mes palëve. Qeveria e Maqedonisë ishte këshilluar nga të gjithë diplomatët e huaj për rreziqet që vë përpara kjo mosmarrëveshje nëse zgjatet më tej dhe se momenti vendimtar është të përpilohet një marrëveshje menjëherë pas Samitit (në veçanti për shkak se zgjedhjet në SHBA dhe për Parlamentin e BE ishin të planifikuara në të ardhmen e afërt). Megjithatë, vendimi për zgjedhje të parakohshme surprizoi shumicën e ekspertëve dhe diplomatëve. Arsyeet pse qeveria vendosi të shkojë në zgjedhje dy vjet pasi u zgjodh nuk kanë qenë krejtësisht të qarta. Një nga opsionet e paraqitura ishte se pas Samitit të Bukureshtit, një bashkim kombëtar ishte i nevojshëm dhe qeveria, pas dështimit lidhur me anëtarësimin në NATO, donte të vërtetojë nëse ende gëzon besimin e popullit. Një tjetër opsion është se qeveria nuk ishte e përgatitur të ballafaqohet si duhet me skenarin e 'vetos' dhe dëshironte të marrë një tjetër mandat në mënyrë që të ketw më shumë kohë në dispozicion për të konsoliduar pozicionin e saj mbi këtë dimension të ri për çështjen e emrit.

---

<sup>9</sup> Wise Men, Center for Strategic Studies, *Review of the Recent NATO Summit: Failure or Success*, [http://www.bilgesam.com/en/index.php?option=com\\_content&view=article&id=113:review-of-the-recent-nato-summit-failure-or-success-&catid=122:analizler-guvenlik&Itemid=144](http://www.bilgesam.com/en/index.php?option=com_content&view=article&id=113:review-of-the-recent-nato-summit-failure-or-success-&catid=122:analizler-guvenlik&Itemid=144)

<sup>10</sup> Deklarata e Samitit të Bukureshtit, e nxjerrë nga kyetarët e shteteve dhe qeverive pjesëmarrëse në mbledhjen e Këshillit Veriatlantik në Bukuresht më 3 Prill 2008, NATO Press Release, 3.04.2008, <http://www.nato.int/docu/pr/2008/p08-049e.html>

2.3 Pa marrë parasysh arsyet, vendimi qe bërë përfundimtar. Parlamenti u shpërbë vetë dhe zgjedhjet u caktuan për 1 Qershorin e vitit 2008. Në periudhën paraelektorale, incidentet ishin të shumta por më së shumti u shkallëzuan më 1 qershor. "Sulme të shumta në zyrat e partisë dhe incidente të tjera të dhunshme kanë ndodhur që kur u bë thirrja për zgjedhje të parakohshme. Incidentet kanë qenë kryesisht në zonat etnike shqiptare në very-perëndim të vendit. Tensionet mbeten të larta në disa rajone. Incidenti më i rëndësishëm ka ndodhur më 12 maj, kur në një sulm jashtë Tetovës në shënjestër ishte lideri i BDI-së, partisë më të madhe etnike shqiptare e përfaqësuar në Parlament.<sup>11</sup>

Zgjedhjet në këtë ditë mund të përshkruhen me fjalën e vetme: dështim. Atmosfera e elektrizuar para dhe Samiti i NATO-s bënë që të regjistroheshin zgjedhjet më të parregullta që nga pavarësimi i Maqedonisë. Rezultati ishte: "një i vrarë në fshatin Haraçinë, pranë Shkupit, disa të plagosur në incidente në Çair dhe në disa vendvotime në Tetovë, Gostivar dhe Kumanovë. Dita e zgjedhjeve filloi me dhunë dhe të shtëna... Për shkak të këtyre incidenteve shumë nga vendet e votimit u mbyllën.<sup>12</sup> "Më shumë se e qartë është se dy partitë rivale shqiptare BDI dhe PDSH vazhduan luftën e tyre për pushtet të filluar që vitin e kaluar në Parlament, ndërsa qeveria nuk i kishte parë shenjat paralajmëruese dhe nuk ndër morri masat e duhura për t'u marrë me incidentet e pritshme.

Kuptohet, zërat e bashkësisë ndërkombëtare ishin mjaft negativ dhe plotë me kritika për mënyrën në të cilën u mbajtën zgjedhjet. Pia Christmas Moller – zëvendës president i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së deklaroi: "Dhuna dhe përpjekjet për të manipuluar fushatën hodhën një hije trishtimi mbi organizimin e zgjedhjeve," "Dhuna ... në zonat etnike shqiptare është një shkelje e papranueshme e paqes dhe të drejtave demokratike të njeriut. "Edhe pse zyrtarë maqedonas administruan zgjedhjet e mirë, ata zbatuan ligjet në mënyrë selektive dhe dështuan në parandalimin e dhunës. Mesazhet nga Brukseli ishin të njëjta: kritika dhe pakënaqësi.<sup>13</sup>

Raporti Vjetor i KE-së është botuar në këtë atmosferë të vitit 2008. Rezultatet e BE-së ishin të parashikueshme dhe autoritetet në vend nuk prisnin ndonjë lajm pozitiv ose një datë për fillimin e negociatave. Faktet kryesore në Raport deklarojnë se "... në zhvillimin e zgjedhjeve standardet kryesore ndërkombëtare nuk janë përmbushur. Dialogu politik ka nevojë të forcohet

---

<sup>11</sup> OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights Election Observation Mission Parliamentary Elections, 2008 Former Yugoslav Republic of Macedonia, *Interim Report 30 April – 19 May 2008*, page 1.

<sup>12</sup> Olivera Vojnovska, Utrinski Vesnik, Zgjedhjet e parakohshme në Maqedoni sollën viktimën e parë (*The Early Elections in Macedonia Took the First Victim*), 2 Qershor 2008, <http://utrinski.com.mk/default.asp?ItemID=649BE176680F8C429ED7FE1251EAF88A>

<sup>13</sup> Macedonian Neës, OSCE-ODIHR thonë së zgjedhjet në Maqedoni ishin nën standardet e pritura <http://www.vmaqedonianews.com/2008/06/osce-odih-r-say-elections-in-macedonia.html>

dhe me qëllim për të lejuar funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të institucioneve politike, në mënyrë të veçantë të Parlamentit.<sup>14</sup> "Kjo ishte hera e parë që Maqedonia nuk përmbushi kriteret politike, të cilat llogariten si pjesë më e rëndësishme e kriterëve të Kopenhagës . ëndrime positive kishte vetëm në fushën ekonomike pasi tregu dhe insitucionet ekonomike kishin shënuar trende positive.

Me këto ngjarje të turbullta Maqedonia kaloi nga 2008 në vitin 2009.

### **3. Zhvillimet më të reja 2008-2009.**

#### **3.1 2009 zgjedhjet lokale dhe presidenciale,**

#### **3.2 vazhdim me reformat dhe negociatat për çështjen e emrit.**

#### **3.3 Negociatat me Greqinë për emrin dhe ndikimin e tyre në Maqedoni duke u përgatitur dhe marrjen e datës për fillimin e negociatave.**

3.1 Pas turbulencava të vitit 2008 që lanë shenjë në zhvillimin e Maqedonisë, 2009 u konsiderua si një rreze shprese për fillime të reja dhe rikthim në rrugën e reformave. Hap i parë dhe më i rëndësishëm ishte organizimi i zgjedhjeve të rregullta lokale dhe presidenciale të planifikuara për në mars të të njëjtit vit. Këtë herë duket se të gjitha partitë politike të përfshira ishin të vendosur që të sillen ashtu siç është I ka hije të sillësh në një shoqëri demokratike. Kjo pasi bashkësia ndërkombëtare kishte theksuar shumë herë se e ardhmja e vendit është në rrezik. Zgjedhjet kaluan në atmosferë shumë të mire, me disa incidente të vogla, por vlerësimi i përgjithshëm ishte se këtë herë autoritetet kanë kryer punën e tyre siç duhet. "Është një kënaqësi për të parë se vendi ka bërë shumë hapa në rrugën e demokracisë për dallim nga zgjedhjet e verës së kaluar ... Egzistojnë ende disa parregullsi dhe mungesë e besimit, dhe ato duhet të trajtohen më tej, por nuk ka dyshim se vendi ka bërë përpjekje të mëdha në mbajtjen e zgjedhjeve sipas standardeve ndërkombëtare, - tha nënkryetar i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, Pia Christmas – Miller.<sup>15</sup> "Përfaqësuesit e BE-së dhe ambasadori i SHBA u shprehën të kënaqur edhe me zgjedhjet dhe mënyrën si ato u zhvilluan. Për më tepër, partia në pushtet VMRO-DPMNE fitoi këto zgjedhje, shumica e kryetarëve të komunave u zgjedhën nga rradhwt e kësaj partie tyre. President i Republikës u zgjedh gjithashtu kandidati nga rradhët e partisë në pushtet. Nga blloku shqiptar shumicën e votave e fitoi BDI.

---

<sup>14</sup> Faktet kryesore në Progres Raportin 2008 për IRJM, faqe 1.

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press\\_corner/key\\_documents/reports\\_nov\\_2008/keyfindings\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/key_documents/reports_nov_2008/keyfindings_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_en.pdf)

<sup>15</sup> Dnevnik, Vlerësim I vëzhguesve të jashtëm, zgjedhjet ishin të rregullta por me disa lëshime të konsiderueshme (*Estimation of the International Observers, The Elections ëere regular ëith slight irregularities*), 24 Mars, 2009  
<http://dnevnik.com.mk/?itemID=F142D630C0FC99458FC9CCDD8ACD5690&arc=1>

Pas sinjaleve pozitive nga komuniteti ndërkombëtar dhe rekomandimit nga Olli Rehn se "propozimi për fillimin e negociatave do të varet nga rezultatet e zgjedhjeve..." vendi ishte kthyer në rrugën e drejtë.<sup>16</sup> Kjo e bëri të qartë se autoritetet duhet të punojnë shumë dhe të përshpejtojnë reformat për të korrigjuar kohën e humbur në dy vitet e fundit. Përveç zbatimit të standarteve të mbetura, vëmendje të konsiderueshme kërkojnë edhe kriza ekonomike, mosmarrëveshja e emrit me Greqinë dhe procesi i liberalizimit të vizave që ka filluar në 2008.

3.2 Duke parë përparimin e Maqedonisë, që prej janarit 2009, mund me lehtësi të konkludohet se ky vit ishte më i suksesshëm për sa u përket reformave të nevojshme për liberalizimin e vizave dhe më pak në negociatat me Greqinë mbi çështjen e emrit. Nga pesë vendet e Ballkanit perëndimor<sup>17</sup>, Maqedonia mori notat më të lartë nga Komisioni mbi zbatimin e masave të nevojshme dhe bërjen e reformave të kërkuara. Këto janë katër kategoritë të cilave ekspertët u kushtuan rëndësi të veçantë: Siguria e dokumenteve; emigracioni ilegal, rendi publik dhe siguria, marrëdhëniet me jashtë dhe të drejtat themelore. Vlerësimet e përgjithshme mbi këto fusha janë: "... se Maqedonia i plotëson kushtet për udhëtim pa viza, se Mali i Zi dhe Serbia kanë përmbushur shumicën e kushteve për udhëtim pa viza, dhe se Bosnje-Hercegovina dhe Shqipëria (ende) nuk i plotësojnë kushtet për udhëtim pa viza. Kosova, shteti i gjashtë i Ballkanit Perëndimor, shtetasve të të cilit u kërkohet gjithashtu vizë për të udhëtuar në BE, ende nuk është përfshirë në këtë proces që çon në liberalizimin e vizave ..."<sup>18</sup> Me këtë, në korrik 2009, Komisioni ka rekomanduar dhënien e liberalizimit të vizave për Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Kjo ka qenë një nga sukseset më të mëdha të Maqedonisë në katër vitet e fundit që kur iu dha statusi i vendit kandidat. Duke marrë parasysh problemet që kanë ndodhur në vitet e mëparshme dhe frika se vendi ka humbur në rrugën e reformave, rekomandimi vjen në kohën e duhur (edhe pse shumë njerëz thonë duke përfshirë edhe autorin e këtij raporti që një vend me dy milion banorë nuk kërcënohet nga ndonjë fluks i madh emigrantësh dhe se është dashur që më herët të kemi mundësinë për të udhëtuar, sidomos të rinjtë dhe studentët).

---

<sup>16</sup> Dnevnik, Rehn uron dhe përkujton detyrat (Rehn gives congratulations and reminds of the obligations), 7 Prill 2009, <http://dnevnik.com.mk/?itemID=D88C8B94B67C214690D8DCEC12475757&arc=1>

<sup>17</sup> Përveç Maqedonisë, edhe Serbia, Mali i Zi, Shqipëria dhe BH kanë negociuar me KE për liberalizim të vizave. part from Macedonia, Serbia, Montenegro, Albania and Bosnia and Herzegovina ëere also negotiating ëith the EC about the visa liberalization. Kishte disa druajtje se shtetet do të shpërblehen "në pako" dhe se MAqedonia do të duhet të presë derisa shtetet tjera përmbushin kushtet edhe pse është i vetmi shtet me statuin e kandidatit. Megjithatë, shtetet u vlerësuan në nivel individual.

<sup>18</sup> Scorecard – Schengen White List Conditions 22 May 2009 (Bazuar në vizita të ekspertëve dhe vlerësimeve të brendshme nga KE për implementimin e mapës së liberalizimit të vizave nga vendet e Ballkanit Perëndimor (18 Maj, 2009) European Stability Initiative, faqe 2.



Zhvillime pozitive ka pasur edhe në shumë fusha të tjera gjithashtu. Në vitin 2009 Qeveria ka qenë e fokusuar më shumë në reformat e nevojshme dhe të rekomanduara. Ky fakt u miratua edhe nga z. Ervan Fuere, Përfaqësues Special i Bashkimit Evropian dhe Udhëheqës i Delegacionit të Komisionit Evropian në Shkup, në një intervistë të kohëve të fundit për gazetën ditore Dnevnik. Ai deklaroi se "arsye për vonesat në procesin e reformës në 2007 dhe 2008 janë shumë të njohura. Këto arsye kanë treguar se e vetmja mënyrë për të korrur sukses në reformat dhe në përmbushjen e pritjeve të qytetarëve janë përpjekjet e përhershme dhe të vazhdueshme. Kjo krijon një klimë pozitive për dialog politik mes të gjitha partive politike, në të gjitha pjesët e shoqërisë ... Ne jemi të kënaqur nga përpjekjet e udhëheqësve. Progresi në reformat e tjera dhe projekt-ligjet që janë në procedurë parlamentare janë gjithashtu shumë inkurajuese."<sup>19</sup>

Përfaqësues të tjerë zyrtarë të institucioneve të BE-së ndajnë qëndrimet e njejta me z. Fuere rreth reformave të Maqedonisë. Qëndrimi zyrtar është se Maqedonia ka bërë përparim të mjaftueshëm deri në muajin shtator dhe se u shënua më shumë progres në gjatë muajt e fundit se sa në katër vitet e fundit. Përveç kësaj, ekziston dialog më konstruktiv nga autoritetet kur është fjala për reformat dhe zbatimin e tyre në periudhën e fundit. Është deklaruar gjithashtu se zgjedhjet e këtij viti të mbajtura në mënyrën e duhur, hapin rrugë mundësive të reja pas zgjedhjeve të 2008 që erdhën si një shpërthim (surprizë e keqe) për BE-në.<sup>20</sup> Për më tepër, gjatë vizitës së kryeministrit në Komisioni, më 1 shtator 2009, Komisioneri i BE për zgjerimin, Olli Rehn deklaroi se "vendi i bën një përparim të mirë në përmbushjen e tetë standardeve dhe nëse ajo ia del për të përmbushur pjesën tjetër të reformave, ne (KE) do të jetë në gjendje të sugjerojë këtë vit datë për fillimin e negociatave ..."<sup>21</sup> "Klima pozitive në KE lidhur me përparimin e Maqedonisë për këtë vit megjithatë, nuk ka larguar vëmendjen nga çështjet e mbetura të cilat duhet të trajtohen. Reformimi është ende i nevojshëm kur vjen puna te dialogu politik mes palëve, administratës publike dhe gjyqësorit, dhe lufta kundër korrupsionit, çështje në të cilat përparimi i Maqedonisë është ende e brishtë.

Nga këndvështrimi maqedonas, konsensusi i përbashkët në Qeveri është se vendi ka bërë përparim të konsiderueshëm vitin e kaluar dhe madje edhe më shumë se në vitet e mëparshme. Sipas zëvendës-kryeministrit, Vasko Naumovski (përgjegjës për çështje evropiane),

---

<sup>19</sup> Dnevnik, Evrorama, Qëndrimet e UE-së dhe Qeverisë së Maqedonisë mbi proceset euro-integruese të Maqedonisë. <http://dnevnik.com.mk/?itemID=BEF25DC7B0659B4192CEF8496A105304&arc=1>

<sup>20</sup> Intervju me Patrick Paquet, Kryetar I sekcionit politik në Delgacionin e KE në Shkup, mbajtur më 27 Gusht, 2009.

<sup>21</sup> Slobodanka Jovanovska, Utrinski Vesnik, *Ren: Maqedonia ka shansa reale për datë (Rehn: Macedonia has real chances for getting a date)*, 2 Shtator 2009, <http://utrinski.com.mk/?itemID=55CA65F80E97B34AA24274D32428EF7C>

autoritetet përgjegjëse po bëjnë përpjekjet maksimale për të përmbushur të gjitha detyrat në kohë.<sup>22</sup> Ka rreth tre javë deri afat për zbatimin e të gjitha detyrimeve të nevojshme dhe ne tani për tani jemi të kënaqur me dinamikën në të cilin ata janë përfunduar. "Ajo që ende mbetet për t'u bërë janë miratimi i amendamenteve të Ligjit për nëpunësit shtetërorë.

Sigurisht një çështje që mbetet për t'u përgjigjur është nëse të gjitha kërkesat e renditura si objektiva janë plotësuar dhe nëse mosmarrëveshja e emrit me Greqinë do të luajë një rol në dhënien e dritës jeshile për fillimin e negociatave për anëtarësim me BE?

3.3 Siç u përmend në kapitujt e mëparshëm, mosmarrëveshja e emrit të Maqedonisë u shëndërrua në temë tepër dramatike në dy vitet e fundit. Mosmarrja e ftesës për anëtarësim në NATO vendosi Maqedoninë në një situatë relativisht të pakëndshme. Greqia, duke kundërshtuar haptas anëtarësimin e fqinjët të saj ka demonstruar qëndrueshmëri mbi mosmarrëveshjen rreth emrit. Nuk ka asnjë diskutim në lidhje me atë se kompromisi lidhur me emrin duhet të arrihet para se Maqedonia të hyjë në NATO dhe BE, të paktën derisa votimet bëhen në mënyrë të njëzëshme.

Me gjithë përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare dhe ndërmjetësit të emëruar nga ana e OKB-së, z. Methju Nimitz, të dyja palët qëndrojnë fuqishëm në pozicionet e tyre të kundërta duke mos arritur ende kurfarë marrëveshje. Disa bisedime, megjithatë të paverifikuara, nga zyrtarë të të dyja anëve ose BE-së, shprehen që me liberalizimin e vizave dhe rekomandimet e mundshme për hapjen e negociatave, Maqedonia do të fitojë nxitjen e duhur për të bërë një kompromis lidhur me emrin e saj në periudhën që vjen. Mbetet për t'u parë si autoritetet maqedonase do të veprojnë dhe nëse Raporti i KE-së I këtij viti do të jetë pozitiv.

Një tjetër ngjarje e rëndësishme që mund të ndikojë në rrjedhën e procesit të negociatave është ai zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Greqi, të planifikuara për 4 tetor. "Sipas sondazheve të fundit, opozita (Lëvizja Socialiste e Jorgos Papandreu (PASOK) ka 6.4% mbështetje më të madhe krahasuar me partinë në pushtet Nea Demokratia të kryeministrit Kostas Karamanlis."<sup>23</sup> Shumë analistë konsiderojnë se ndryshimi i dukshëm i partisë në pushtet do të ndihmojë që negociatat për emrin të futen në fazën e fundit pasi PASOK-u tregon qëndrime më pozitive ndaj kontestit për emrin. "... Edhe para se të merret vendimi për zgjedhje të parakohshme, Andreas Loverdos, një nga bashkëpunëtorët e afërt të Jorgos Papandreut ka

<sup>22</sup> Dnevnik, Evrorama, Qëndrimet e UE-së dhe Qeverisë së Maqedonisë mbi proceset euro-integruese të Maqedonisë. <http://dnevnik.com.mk/?itemID=BEF25DC7B0659B4192CEF8496A105304&arc=1>

<sup>23</sup> A1 Lajme, Zgjedhjet e parakohshme në Greqi, 4 Tetor (*Early Elections in Greece on 4<sup>th</sup> of October*), <http://a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=113292>

deklaruar se kur ata të vijnë në pushtet problemi me emrin do të zgjidhet ...<sup>24</sup> Çfarë do të jetë ndikimi i ngjarjeve në tetor 2009 mbi marrëdhëniet e ardhshme të dy vendeve, mbetet për t'u parë.

4. Analiza krahasuese rreth qëndrymeve zyrtare të Delegacioni të KE dhe Sekretariatit për Çështje Evropiane në lidhje me përparimin e Maqedonisë që nga viti 2005 dhe pritjet nga Raporti i KE 2009.

Mendimet e të dyja palëve më të shqetësuara (Qeveria dhe KE) janë më se të nevojshme në mënyrë që lexuesit të kenë një imazh të qartë mbi qëndrimet e palëve kur bëhet fjalë për përparimin e Maqedonisë që nga viti 2005. Që të dyja palët janë të lidhura drejtpërdrejt me procesin e reformave dhe pranimin në BE, andaj pikëpamjet e tyre janë vendimtare për të hartuar një raportim të balancuar mbi përparimin e bërë në katër vitet e fundit si dhe pritjet e mundshme nga Raporti i ardhshëm i KE-së. Megjithatë, vetëm Delegacioni i KE - Misioni i BE-së në Shkup iu përgjigj kërkesës sonë për një takim në të cilin u diskutua zhvillimi i Maqedonisë. Për fat të keq, përkundër përpjekjeve të shumta për të realizuar një takim me Sekretariatit për Çështje Evropiane pranë Qeverisë së Maqedonisë, nuk arritëm të marrim asnjë përgjigje definitive.

Me këto zhvillime, autorit i mbetet të mbështetet në deklaratat e zyrtarëve të paraqitura në media, pa pasur mundësinë për të paraqitur drejtpërdrejt qëndrimin zyrtar të Sekretariatit. Arsytet për këto veprime të Sekretariatit, në kohën kur bashkëpunimi i afërt me publikun është i inkurajuar dhe rregullohet me ligj, mbeten ende të panjohura.

Në kapitujt e mëparshëm fokusi ishte mbi reformat dhe synimet që Maqedonia duhet të përmbushë në mënyrë që të marrë datën për fillim të negociatave. Megjithatë duhet theksuar se shumë pak dihet për kompleksitetin e procedurës që pason pasi që rekomandimi është dhënë nga ana e KE-së, një procedurë që si duket është edhe më e rëndësishme se vetë rekomandimi. Pas dhënies se rekomandimit për fillimin e negociatave nga KE, këshilli bie dakord për hapjen e këtyre negociatave me vendin aplikant në fjalë.<sup>25</sup> Periudha në mes është shumë e rëndësishme sepse në këtë fazë realizohet identifikimi i boshllëqeve.<sup>26</sup> Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit pason ndërtimi i një kornize për fillimin e negociatave. Kapitujt hapen

<sup>24</sup> Nova Makedonija, Emri nuk është një nga temat kryesore të zgjedhjeve në Greqi, (*The Name is Not One of the Main Topics on the Elections in Greece*),

<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=949942349&id=9&setIzdanie=21780>

<sup>25</sup> Intervju me Patrick Paquet, Kryetar i sekcionit politik në Delgacionin e KE në Shkup, mbajtur më 27 Gusht, 2009.

<sup>26</sup> Procesi i identifikimit të boshllëqeve kryhet nga Komisioni në bashkëpunim me vendin përkatës. Sektor pas sektori, nxjerrren mapa për secilin vend aplikant që tregojnë se cilat instrumente legislative duhet të hyjnë në fuqi ose të ndryshohen me qëllim që vendet anëtare të ardhshme do të jenë të afta t'i përmbahen legjislacionit sa më shpejtë të jetë e mundshme pas kycjes.

njëri pas tjetrit bazuar në miratimin e kornizës nga shtetet anëtare. E rëndësishme që të dihet është se gjatë rrjedhës së këtyre procedurave, duhet të ndryshohet mentaliteti i vendit kandidat (kjo do të thotë se duhet të marrë seriozisht këto negociata dhe të veprojë sikur tashmë është shtet anëtar, me qeveri të përgjegjshme, funksionimi të demokracisë dhe sundimit të ligjit). Sapo korniza të jetë miratuar dhe ka një marrëveshje midis BE-së dhe vendit kandidat për të cilin janë hapur kapitujt, pason një lajm tjetër të rëndësishëm: ato që kryejnë negociatat nuk janë ndërmjet KE-së dhe vendit kandidat, por të gjitha 27 shtetet anëtare me vendin kandidat. KE këtu vepron në emër të tyre. Për më tepër ka 62 vendime krejtësisht të cilat duhet të miratohen njëzëri pasi rekomandim është dhënë dhe para përfundimit të negociatave dhe rekomandimit për anëtarësim të plotë.

Procedurat e lartpërmendura tregojnë kompleksitetin e procesit të negociatave midis vendit kandidat dhe BE dhe shtetet anëtare të saj. Pjesa më e vështirë nuk është marrja e datës, por më pas puna e nevojshme për të përfunduar bisedimet në një kohë të arsyeshme dhe me rezultatet të mira (kushtet pas hyrjes së Rumanisë dhe Bullgarisë janë më të rrepta gjë që e bën këtë detyrë të vështirë për vendet e BP). 62 vendimet ndoshta duket të jenë shumë larg për momentin, por pasi data për botimin e Raportit Vjetor të KE-së po afron dhe qëndrimi pozitiv në mes të ekspertëve dhe zyrtarëve të BE-së në lidhje me rekomandimin e një date, autoritetet duhet të marrin parasysh lëvizjet e tyre të mëtejshme me mençuri. Fakti se këto vendime merren në mënyrë unanime dhe me që ato përfshijnë edhe votimin e Greqisë, paraqet momentin e duhur për gjetjen e një zgjidhjeje konstruktive për mosmarrëveshjen e emrit.

Rekomandimi për një datë është pa dyshim një mirënjohje e madhe për përpjekjet e Maqedonisë në zbatimin e reformave, por nuk duhet që të harrohet detyrat edhe më të rënda pasojnë pas marrjes së datës për fillim të negociatave.

## **5. Analizë përfundimtare dhe paraqitje e qëndrimit të Analytica-s: A do të marrë Maqedonia rekomandimin e datës për fillimin e negociatave me BE?**

Duke hedhur një shikim nëpër katër vitet e kaluara dhe duke analizuar komentet dhe deklaratat nga BE-ja dhe Qeveria, mund të konkludohet se vërejtjet më pozitive erdhën në gjashtë muajt e fundit të këtij viti. Ndjenja e përgjithshme është se BE-ja në vend që të kritikojë dhe vendos kushte të reja për Maqedoninë, vendosi që atë ta inkurajojë të vazhdojë me reformat dhe çështjen e vështirë të emrit. Kjo mund të jetë për shkak të frikës që vjen nga shumë autorë se vendet e BP po humbin besimin e tyre në procesin e integritit në BE dhe se ..." nëse BE dëshiron të mbajë vendet në rrugën e zhvillimit duhet të miratojë një qasje më pluraliste për procesin e reformave në këtë rajon.<sup>27</sup> Megjithatë, me të ardhmen e pasigurt të traktatit të

---

<sup>27</sup> Radio Evropa e lirë, Radio Liberty, Komisioni I Helsinkit urdhëroi që të ripërtërihet angazhimi I SHBA-ve në Ballkanin Perëndimor, Ivana Hoëard.

Lisbonës, krizës globale ekonomike, ndikimit negativ nga pranimi i hershëm I Rumanisë dhe Bullgarisë, u dëshmuar si një detyrë Sifiane si pasojë e mendimit negative të shteteve anëtare lidhur me zgjerimin. Gjithashtu konfliktet e shumta ende të pazgjidhura rajonale po pengojnë dukshëm rolin e BE-së në Ballkanin Perëndimor. Gjetja e një ekuilibri të duhur midis këtyre çështjeve dhe zgjerimit do të jetë mjaft sfiduese për Unionin dhe për vendet aspiruese. Mbetet të shihet në periudhën që vjen në ç' mënyrë do të zhvillohen këto marrëdhënie.

Duke parë përparimin e Maqedonisë dhe pritjet nga Raporti i 2009 I KE-së, analiza tregoi se ekspertët e huaj si dhe përfaqësuesit e KE-së në Maqedoni tregojnë optimizëm në lidhje me datën e negociatave. Përfundimi është se ka patur më shumë përparim në gjashtë muajt e fundit se sa në tre vitet e fundit dhe se autoritetet në Maqedoni shfaqin një gjuhë më konstruktiv në lidhje me miratimin dhe zbatimin e tetë standardeve dhe vazhdimin e reformave. Gjithashtu edhe Qeveria kohët e fundit në paraqitjet e saja në media ka treguar një opinion pozitiv mbi shanset e saj për të marrë rekomandim për datën e fillimit të negociatave me BE-në. Inkurajimi i parë erdhi në gusht me dritën e gjelbër për procesin e liberalizimit të vizave që ka dhënë ndjenja për publikun se vendi është shpërblyer për përpjekjet e tij në procesin e përafrimit. Kushti i fundit për Maqedoninë para se raporti i KE-së të botohet në 14 tetor ishte miratimi i 4 ligjeve të rëndësishme:

- 1) Ligji mbi reformat e policisë;
- 2) Ligji për financimin e partive politike;
- 3) Ligji për parlamentin;
- 4) Ligji për nëpunësit shtetëror.

Nga ligjet e lartpërmendura vetëm Ligji për nëpunësit shtetëror mbetet të miratohet para se të publikimit të raportit vjetor më 14 tetor. Ka ekspertë të huaj që punojnë me autoritetet maqedonase për të bërë këtë ligj sipas standardeve të BE-së kështu që të mundësphet miratimi I ligjit me shumicë të kualifikuar.

Duke analizuar të gjitha të dhënat e paraqitura në këtë raport së bashku me intervistat e kryera, mund të konkludohet se Maqedonisë I ka munguar një përparim thelbësor në tre vitet e fundit. Incidentet në Parlament, problem I pazgjidhur me Greqinë rreth emrit, moshyrja në NATO, zgjedhjet e parregullta me incidentet e shënuara lanë një shenjë të zezë në përpjekjet e Maqedonisë për t'u bashkuar në familjen e madhe evropiane. Me presionin e brendshëm dhe të jashtëm, këtë vit autoritetet filluan të punojnë në përmbushjen e reformave me më shumë përkushtim dhe me ritëm më të shpejtë, duke përdorur gjuhë më konstruktive si në marrëdhëniet e brendshme ashtu edhe të jashtme. KE pranon këtë trend pozitiv, vlerëson

përpjekjet e vendit për këtë vit, në të njejtën kohe duke potencuar se reformat janë shumë larg nga përmbushja e plotë.

Siç u përmend më parë, procesi i liberalizimit të vizave tashmë ka filluar. Ky proces paraqet një nxitje dhe mirënjohje për Maqedonia pasi ajo mori vlerësimet më të larta për reformat krahasuar me katër vendet e tjera të Ballkanit. Kushti I fundit që të marrë vërrejtje pozitive është miratimi i disa ligjeve të rëndësishme. Me miratimin e ligjit të fundit dhe atmosferën positive që mbizotëron në KE, pritjet për marrjen e datës për fillimin e negociatave janë shumë të larta. Kjo nuk do të thotë që do të bëhet hapja e menjëhershme por gjithsesi ndikon pozitivisht në angazhimin sa më të madh të Maqedonisë për të vazhduar me reformat, si dhe një nxitje që qeveria të punojë më shumë në gjetjen e një kompromisi për emrin në mosmarrëveshjen me Greqinë.

### **Vërejtjet përfundimtare**

Konkluzioni I fundit I nxjerrë nga analizat e bëra në raport u paraqit paraprakisht në kapitullin e fundit të këtij raporti ku theksohet: miratimi I shpejtë I ligjit të fundit ne Parlamentin e Maqedonisë dhe atmosfera positive në KE lidhur me progresin e Maqedonisë bëjnë që pritjet për marrjen e datës për fillim të negociatave me raportin vjetor të KE-së të jene shumë të larta.

Megjithatë, përpjekjet nuk mund të mbarojnë këtu pasi që procesi I hapjes së negociatave është shumë më I vështirë dhe kërkon përgaditje të mirë. Edhe pse kjo mund të duket shumë larg nga perspektiva e sotme, vazhdimi me përmbushjen e reformave do të kontribuojë në ecjen e shpejtë të negociatave për antarësim.

Vërejtja përfundimtare e këtij raporti do të jetë: edhe në rastin më të keq – mosmarrja e një date për negociata, Maqedonia duhet të vazhdojë progresin dhe përmbushjen e reformave pasi që nuk mund të "thyejë derën në të cilën është duke trokitur për kaq kohë .

---

## EU Approximation and Integration Advocacy Program

“Katër vite nga marrja e statusit – vend kandidat:  
Çfarë është bërë dhe cilat janë pritjet?”

Sonja Risteska, Hulumtues  
sristeska@analyticamk.org

Publikim i ardhshëm:

Përfundimet e nxjerra nga Tryeza e rrumbullakët me temë: Katër vite nga marrja e statusit – vend kandidat: Çfarë është bërë dhe cilat janë pritjet?

---

**Analytica**

Web: [www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)

Email: [info@analyticamk.org](mailto:info@analyticamk.org)

Dame Gruev No: 7-8/3

1000 Skopje, Macedonia

Phone: 00 389 (0)2 3121 948

Fax: 00 389 (0)2 3121 948

---